PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA DURRES**
**Nr. 3038 Rep.**
**Nr. 886 Kol.**

## VENDIM I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "PERLA" SHPK

Ne Durres sot me dt. 15.04.2003, une noteri Mihal Kazanxhi, asistova ne mbledhjen e asamblese se ortakeve te Shoqerise "**PERLA**" **SHPK**, me seli ne L.13, Iliria-Plazh-Durres,e perbere nga **ORTAKU i VETEM** i shoqerise

**Z.ILIAZ HASANBELLI:** biri i Skenderit, dtl.1959, banues ne Durres, L.13,Iliria-Plazh-Durres, identitetin e te cilit e vertetova me pasaportetn Nr.0557333, zoterues i kuotes 100% me zotesi te plote juridike e per te vepruar ...

Ortaku i Vetem-Administrator e deklaron mbedhjen te hapur me kete

**REND DITE:** 1. Zmadhimi i kapitalit te shoqerise "**PERLA"SHPK**.
2. Emerimi ne rruge gjyqesore i nje eksperti per vleresimin e gjendjes financiare te shoqerise "**PERLA"SHPK**.

Fillon shqyrtimi i ceshtjes qe perben Rendin e dites...

*RELATON ORTAKU I VETEM- ADMINISTRATOR Z.ILIAZ HASANBELLI:*

Shoqeria "**PERLA"SHPK**, eshte themeluar me dt.21.06.1996 nga Ortaku i Vetem Z.Arjan Laci me kuote 100%, i cili ka qene edhe Administrator i saj dhe ka fituar Personalitet Juridik me vendimin Nr.15660,dt.19.8.1996 te Gjykates se Rretiht Tirane.

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie, aktualisht eshte 100.000 leke.

* Me kontraten e dhurimit Nr.2707/321, dt.16.07.1998 une Iliaz Hasanbelli, kam fituar te drejten e ORTAKUT TE VETEM te shoqerise "PERLA"SHPK, e cila eshte depozituar ne regjistrin tregtar Tirane, me vendimin Nr.15660/1-5548, dt.22.07.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

* Me pas me vendimin Nr.2, dt.27.07.1998, ne funksion te kontrates se Dhurimit, kam bere ndryshimet perkatese ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e shoqerise, si dhe emrimin e administratorit te ri te shoqerise, te cilat jane depozituar ne regjistrin tregtar, ne baze te Vendimit Nr.15660/2-5564 te Gjykates se Rrethit Tirane....

* Me vendimin Nr.3,dt.02.04.1999, une ortaku i vetem, kam ndryshuar objektin e veprimtarise se shoqerise, duke e perqendruar ate vetem ne fushen e

turizmit, ( BAR, BUFE, RESTORANT, HOTELERI )si dhe kam ndryshuar seline e shoqerise, duke e transferuar ate ne lagjen Nr.13, Iliria-Plazh-Durres, prane Hotel "FLORIDA".

Aktet e mesiperme jane depozituar ne Regjistrin Tregtar me vendimin Nr.15660/3-6408, dt.06.04.1999..

* Gjithashtu me Vendimin Nr.4 dt.26.05.2000, une ortaku i vetem i shoqerise kam vendosur zgjerimin e aktivitetit te shoqerise edhe ne fushen e veprmtarise televizive ( me "TV – DURRESI")...

Ky akt eshte depozituar ne Regjistrin Tregtar me vendimin NR.15660/4 dt.01.06.2000.

Une Ortaku i Vetem i shoqerise "PERLA"SHPK, do te zmadhoj kapitali themeltar te shoqerise. "PERLA" SHPK, nga 100.000 leke ne 40.000.000 (dyzetmiljon) leke..

Per kete, ne baze te dispozitave te Kodit Tregtar duhet paraprakisht te behet vleresimi i gjendjes financiare te shoqerise me nje ekspert kontabel te autorizuar dhe te pregatitet nje raport per efekt zmadhim kapitali....

Konkretisht propozoj qe ky vleresim te behet nga Z.Luan Kamberi ...

Ne perfundim Ortaku i Vetem /Administrator i shoqerise "PERLA" SHPK

**VENDOSI:**

**1)** Zmadhimin e kapitali themeltar te shoqerise "PERLA"SHPK

**2)** Te emerohet ne rruge gjyqesore nje ekspert per vleresimin e gjendjes financiare te shoqerise per efekt zmadhim kapitali..

Mbas legalizimit, nje kopje e ketij vendimi mu dorezua mua noterit, ndersa tre kopjet e tjera i kthehen administratorit..

Me pas Ortaku i Vetem-Administratori e deklaron mbledhjen te mbyllur ... Eshte ora 10.00 e dt.15.04.2003...

**ORTAKU I VETEM I SHOQRISE "PERLA"SHPK**

/ Ilyaz Hasanbelli /

**N O T E R I**

**/ MIHAL KAZANXHI /**

# RAPORT I
# EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

**MBI SHTIMIN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR TE "PERLA"SH.P.K**

**DURRES**

Une I quajturi Luan KAMBERI Ekspert Kontabel I Autorizuar I ngarkuar nga Asambleja e Ortakeve (Ortaku I vetem) I shoqerise "PERLA" Sh.p.k DURRES, dhe I caktuar nga Gjykata e Shkalles se Pare e Rrethit Tirane me Vendimin e saj nr.15.660/5 te dates 22.04.2003 per verifikimin dhe vertetimin e shteses se kapitalit te shoqerise se mesiperme,paraqes raportin tim si me poshte:

Shoqeria "PERLA "sh.p.k eshte krijuar me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.15660 date 19.08.1996.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj nje hapesire te gjere veprimi ne fushen e hotelerise-turizmit-bar-bufe-restorant etj.

Me vendimin nr.15660/1 ortaku I vetem z.Arjan Laci I dhuron 100% te kuotave te shoqerise z.Iljaz Hasanbelli I cili qe nga ky moment eshte ortak I vetem I shoqerise.

Qe nga viti 1998 shoqeria ka ushtruar veprimtari kryesisht ne fushen e hotelerise dhe bar-bufe-restorantit dhe ortaku I vetem I saje ka investuar ne kete fushe duke blere aktive te qendrueshme te cilat I ka vene ne dispozicion te shoqerise.Keto aktive jane rregjistruar rregullisht ne bilnacet financiare te shoqerise dhe kane si burim te financimit te tyre ortakun e vetem Z.Iljaz Hasanbelli.

Vlera e financimeve te bera ne vite qe shoqeria I detyrohet ortakut ne fund te vitit ushtrimor 2002 eshte 60.510.879 leke.Pra vlera qe ortaku mund te riti kapitalin eshte 60.510.879 leke,kjo vere eshte 20.610.879 leke me e madhe se vlera qe ortaku ka vendosur per te shtuar kapitalin e nenshkruar.

Per kryerjen e misionit te ngarkuar per vertetimin e shtese se kapitalit te nenshkruar une jam mbeshtetur ne dokumentat e meposhtme :

-Ne bilancet e shoqerise deri ne fund te vitit 2002

-Ne raportet e auditimit te ketyre bilanceve

-Ne dokumentet ligjore te shoqerise

-Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare te rrethit Tirane nr.15660/5 qe me ngarkon me vertetimin e shteses se kapitalit.

-Ne vendimin e Asamblese se Ortakeve (Ortakut te Vetem) per shtesen e kapitalit te shoqerise.

Sikurse theksova edhe me siper ne fund te vitit ushtrimor 2002 shoqeria "PERLA" sh.p.k ka te pasqyruara ne bilanc ne postin "Ortake"te detyrimeve te kerkueshme mbi nje vite vleren 60.510.879 leke e cila u verteua nga ana e ime dhe perfaqeson derdhje te ortakut per blerje aktivesh te qendrueshme duke filluar nga vitit 1998 e deri ne 31.12.2002.

Per sa me siper kapitali I nenshkruar I shoqerise mbi bazen e vendimit te Asamblese se Ortakeve (Ortaku I Vetem) nga 100.000 leke shtohet dhe me 39.900.000 leke dhe behet 40.000.000 leke dhe shuma e mesiperme zbritete nga zeri "Ortake" I cili nga 60.510.879 leke behet 20.610.879 leke.

Sikurse theksova me siper bilancet e shoqerise per vitet 1999,2000,2001,2002 jane te audituara dhe shifrat e bilancit jane reale.

**SI PERFUNDIM**: une vlersoje dhe vertetoje se kapitali I nenshkruar I shoqerise "PERLA"sh.p.k Durres nga 100.000 leke shtohet dhe me 39.900.000 leke dhe behet 40.000.000 leke.

Durres,me 26.04.2003

**EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR**

**Luan KAMBERI**

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR LUAN KAMBERI N.036 ALBANIA